



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0716

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “LIMITPROJECT” SH.P.K., kundër njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë” me numër të prokurimit 616-24-7202-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA PRISHTINES”, më 20/09/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e OE “LIMITPROJECT” SH.P.K. me nr. 2024/0716, e datës 05/08/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë”, me numër të prokurimit 616-24-7202-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

2. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënje të kontratës, aktiviteti prokurimit me titull “99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë”, me të dhënat si në pikën 1. të dispozitivit.

3. Në përputhje me Nenin 31 paragrafi 5, i Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE “LIMITPROJECT” SH.P.K i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës, mjetet e konfiskuara kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.07.2024, “KOMUNA PRISHTINES” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë” me numër të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 6,760,000.00 €.

Me 08.07.2024, OE "LIMITPROJECT" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.08.2024, Autoriteti Kontraktues e ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05/08/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "LIMITPROJECT" SH.P.K. me nr. 2024/0716 lidhur me aktivitetin "99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë" me numër të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "Limit Project" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 30.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë" me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (se meritum) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"Pika 1: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-nen 2. Menaxher i projektitInxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktive, min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka inxhinier projekte në fushën e ndërtimit min. 8 milion euro në tri vitet e fundit, të prezantojë minimumi 3 projekte me ekspertizë nga lëmi e ndërtimtarisë.... Ju lutemi, si ka mundësi që të kufizohet periudha në vetëm 3 vite për vlerën 8 milion pune të menaxhuara nga menaxheri i projektit, kur, nëse një menaxher ka menaxhuar një projekt me vlerë me të madhe se 8 milion në vitet me herët dhe përvoja e menaxherit sa me e gjatë në aspektin kohor, krijon përvojë dhe ekspertizë me të madhe. Gjithashtu, ju lutemi na sqaron se çka keni menduar me kërkesën për ekspertizë për se paku 3 projekte. Si dhe të na definoni se kush duhet të certifikojë personat për instruktor nuk e keni definuar dhe shpjeguar në përgjigjen për sqarim?"

Pika 2: Udhëheqësi i udhëheqësit të punishtes, kush duhet ta beje certifikimin në fushën e infrastrukturës rrugore. Gjithashtu, a ka ndonjë arsye që Inxhinieri i Ndërtimit menaxher i punishtes, që të jete i certifikuar për auditimin e energjisë kur duhet që inxhinieri projektues duhet të ketë këtë përgatitje? • Ing.infrastruktures nuk ka nevojë për ekspertizë të energjisë, pasi që certifikimi për auditim të energjisë ,nuk ka lidhje me energjinë, por vetëm në çështjen e efijences energjetike Efijenca arrihet në projektin ?

Pika 3: Nuk e kemi kuptuar pse e keni vendosur e niakatronikes- si dhe pse është kërkuar të ketë hartuar projekte, nëse projekti veç është bere dhe po krijon konfuzion nëse është ekzekutimi apo projektim. Ing i makatronikes mund të zëvendësohet me elektrik ose makineri?

Pika 4: Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes - kompjuterik me telekoniunikacion? Cili pozicion në paramasë e kërkon dhe pse duhet hartim projektesh? Në pjesën e kërkesës suaj, keni parapara provojë në hartimin e projektit. Duhet ditur nëse kontrata do tejet zbatim apo projektim. Prandaj ing duhet të ketë provojë në ekzekutim.

Pika 5: Inxhinier i makinerisë - komunikacion, pse është kërkuar referenca për projektim kur projekti është ekzekutimi! Projektimi nuk e ngrit profesionalisht për zbatimin kontrata e shpallur -vendimi është për zbatim jo projektim. Prandaj ing duhet të ketë provojë në ekzekutim.

Pika 6: Operatori ekonomik duhet të prezantoj listën e stafit të dorëzuar në ATK për tri vitet e fundit 2021,2022 dhe 2023. Fuqia mesatare për tri vitet duhet të jete min, 50 punëtor. Pse duhet të jene raporti për 3 vite kur ligji i prokurimit e lejon mundësinë që të bëhen kontrata në vepër dhe angazhimi i fuqisë punëtore të behet vetëm për këtë projekt. Kërkesa është e çuditshme! Nëse kompania ka qen solide në 3 vitet paraprake ,por në vitin aktual nuk posedon fuqinë punëtorë, si ka mundësi të fitojë.

Pika 7: Te punësuarit, sipas pikës 12, certifikimi nga kush duhet të jete për pllakashtrues, zdrukthëtar etj, apo mund të ketë vetën referencën nga kompania punëdhënëse! Nuk keni specifikuar nga cili institucion të lëshohen certifikimet në përgjigjen për sqarim ose të hiqet kriteri.

Pika 8: Sipas pikës 14, OE duhet të jete prodhues ose të ketë marrëveshje të ndonjë prodhues të elementeve të parafabrikuara nga betoni i parandëruar Certifikatë cili veprimtarisë, e përcakton certifikimi për këto veprimtari, dhe referencat e punëve të kryera, apo certifikime ndërkombëtare nga cili institucion nuk e keni specifikuar në përgjigjen për sqarim. Ose të hiqet ky kriter ose të specifikohet institucioni për certifikim. Pika 9 Kërkesa 17. OE duhet të dëshmoj se sistemi menaxhuar i ofertuesit përmbushë kriteret e përcaktuara nën fushën e ndërtimitarisë se paku për këto ISO Standard: -ISO 9001 2015; -QMSISO 9001-2015 (Internal Auditor); -ISO 14001-2015; -EMS ISO 14001-2015 (Internal Auditor);- ISO 45001-2018: -DS CEN TR 15128-2005; -EN SIO 1452-1 2009; -EN ISO 50001-2018:-EN ISO 39001-2012; Intemal Auditor, nuk e keni shpjeguar nga çfarë institucioni në përgjigjen për sqarim?"

Lidhur me pretendimet ankimore duhet sqaruar se me datë 31.07.2024 AK ka publikuar Formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara me ç ‘rast janë ndryshuar plotësuar disa kërkesa të DT për të cilat edhe parashtruesi ka prezantuar pretendimet e tij ankimore përmes kërkesës për rishqyrtim. Me këtë rast AK ka marrë parasysh edhe kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit. Megjithatë pjesa tjetër e pretendimeve ankimore përtej kërkesave të

DT që tanimë janë ndryshuar nga AK, si të tilla janë të pabazuara pasi që kërkesat e mbetura në DT janë të domosdoshme për të arritur qëllimin e synuar të aktivitetit të prokurimit. Për më tepër, pa këto kërkesa është e pamundur që të realizohet me sukses kontrata që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “LIMITPROJECT” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim: pretendimet ankimore të OE ankues:

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Pika 1: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-nen 2. Menaxher i projektit-Inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë konstruktive, min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, te ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte ne fushën e ndërtimit min. 8 milion euro ne tri vitet e fundit, te prezantoje minimumi 3 projekte me ekspertiza nga lëmi e ndërtimitarisë.... Ju lutemi, si ka mundësi qe te kufizohet periudha ne vetëm 3 vite për vlerën 8 milion pune te menaxhuara nga menaxheri i projektit, kur, nëse një menaxher ka menaxhuar një projekt me vlere me te madhe se 8 milion ne vitet me herët dhe përvoja e menaxherit sa me e gjate ne aspektin kohor, krijon përvoja dhe ekspertize me te madhe. Gjithashtu, ju lutemi na sqaron se çka keni menduar me kërkesën për ekspertize për se paku 3 projekte. Si dhe te na definoni se kush duhet ti certifikojë personat për instruktor nuk e keni definuar dhe shpjeguar në përgjigjen për sqarim? - ne nuk kemi marre përgjigje as ne sqarim dhe as ne kërkesën për rishqyrtim.

Pika 2: Udhëheqësi i udhëheqësit te punishtes, kush duhet ta bej certifikimin ne fushën e infrastrukturës rrugore. Gjithashtu, a ka ndonjë arsye qe Inxhinieri i Ndërtimit menaxher i punishtes, qe te jete i certifikuar për auditimin e energjisë kur duhet qe inxhinieri projektues duhet të ketë këtë përgatitje? Ing.infrastruktures nuk ka nevojë për ekspertizë të energjisë, pasi qe certifikimi për auditim te energjisë ,nuk ka lidhje me energjinë, por vetëm në çështjen e efqiencies energjetike Efqiencia arrihet në projektim?

Pika 3: Nuk e kemi kuptuar pse e keni vendosur e makatronikes- si dhe pse është kërkuar te ketë hartuar projekte, nëse projekti veç është bere dhe po krijon konfuzion nëse është ekzekutim apo projektim. Ing i makatronikes mund te zëvendësohet me elektrik ose makineri?

Pika 4: Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes - kompjuterik me telekomunikacion? Cili pozicion ne paramasë e kërkon dhe pse duhet hartim projektesh? Në pjesën e kërkesës suaj, keni parapara provojë në hartimin e projektit. Duhet ditur nëse kontrata do te jetë zbatim apo projektim. Prandaj ing duhet të ketë provojë në ekzekutim.

Pika 5: Inxhinier i makinerisë - komunikacion, pse është kërkuar referenca për projektim kur projekti është ekzekutim! Projektimi nuk e ngrit profesionalisht për zbatimin kontrata e shpallur –vendimi është për zbatim jo projektim. Prandaj ing duhet të ketë provojë në ekzekutim.

Pika 6: Operatori ekonomik duhet te prezantoj listën e stafit te dorëzuar ne ATK për tri vitet e fundit 2021,2022 dhe 2023. Fuqia mesatare për tri vitet duhet te jete min, 50 punëtor. Pse duhet

te jene raporti për 3 vite kur ligji i prokurimit e lejon mundësinë që të bëhen kontrata në veprë dhe angazhimi i fuqisë punëtore të bëhet vetëm për këtë projekt. Kërkesa është e çuditshme! Nëse kompania ka qenë solide në 3 vitet paraprake, por në vitin aktual nuk posedon fuqinë punëtore, si ka mundësi të fitojë.

Pika 7: Të punësuarit, sipas pikës 12, certifikimi nga kush duhet të jete për pllakashtrues, zdrukthëtar etj, apo mund të ketë vetëm referencën nga kompania punëdhënëse! Nuk keni specifikuar se nga kush –çfarë institucioni të lëshohen certifikimet në përgjigjen për sqarim, ose të hiqet ky kriter.

Pika 8: Sipas pikës 14, OE duhet të jete prodhues ose të ketë marrëveshje me ndonjë prodhues të elementeve të parafabrikuara nga betoni i parandëruar. Certifikat cili veprimtarisë, e përcakton certifikimi për këto veprimtari, dhe referencat e punëve të kryera, apo certifikime ndërkombëtare nga cili institucion nuk e keni specifikuar në përgjigjen për sqarim. Ose të hiqet ky kriter ose të specifikohet institucioni për certifikim.

Pika 9 Kërkesa 17. OE duhet të dëshmojë se sistemi menaxhuar i ofertuesit përmbushë kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimitarisë së pakës për këto ISO Standard: -ISO 9001 2015; -QMS ISO 9001-2015 (Internal Auditor); -ISO 14001-2015; -EMS ISO 14001-2015 (Internal Auditor); -ISO 45001-2018; -DS CEN TR 15128-2005; -EN SIO 1452-1 2009; -EN ISO 50001-2018; -EN ISO 39001-2012; Internal Auditor, nuk e keni shpjeguar nga çfarë institucioni në përgjigjen për sqarim?

Ne të gjithë këtë, ne kemi bërë edhe kërkesë për sqarim si në kërkesën për rishqyrtim po ashtu edhe në një kërkesë për sqarim ku AK fare nuk ka denjuar të sqarojë se çfarë janë këto dokumente dhe si të dokumentohen dhe ky është diskriminim. Ndërsa po ju bashkëngjisim kërkesën për rishqyrtim si dhe kërkesën për sqarim.

Duke u referuar të pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 6, 7, 64, 66, dhe 69 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) – 39. Sqarimi i Tenderëve .

Duke u mbështetur të neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 07/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0716/24, ndërsa me datë 17/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0716 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK është pajtuar me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertizës.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur të neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 07/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0716/24, ndërsa me datë 17/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0716 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e

OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK është pajtuar me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertizës

-Lidhur me pretendimet e OE "LIMITPROJECT" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0716 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, ka zhvilluar Aktivitetin e Prokurimit me titull: "99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri-Pallati i Rinisë" me nr. të prokurimit: "616-24-7202-5-1-1". Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë: 19.07.2024.

Më datë: 22.07.2024 operatori ekonomik: "LIMITPROJECT SH.P.K."- Prishtinë ka bërë kërkesë për informacion shtesë pranë AK-së në lidhje me kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë. Përgjigje në pyetjet e parashtruara AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS ka dhënë me datë 29.07.2024.

I pakënaqur me përgjigjet e pranuar, OE ankues më datë 30.07.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS. Me datë 31.07.2024 AK në platformën e-prokurimi ka publikuar formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ndërsa me datë 02.08.2024 ka njoftuar operatorin ekonomik "LIMITPROJECT SH.P.K."- Prishtinë se, kërkesa për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.

Me datë 05.08.2024 OE "LIMITPROJECT SH.P.K.", ka parashtruar Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik me pretendimin se disa nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të përcaktuara nga AK nuk janë të definuara dhe janë diskriminuese.

Përgjigje në pretendimet ankimore

OE "LIMITPROJECT SH.P.K.", pretendon se AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, ka bërë shkelje të nenit 1, nenit 2, nenit 6, nenit 7, nenit 64, nenit 66 dhe nenit 69 të LPP-së si dhe nenit 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (Rregullore kjo e cila është shfuqizuar nga KRPP-ja).

Sipas OE ankues, AK-ja nuk ka ofruar sqarime/informacione të mjaftueshme në kërkesën për informacion shtesë, në lidhje me kërkesa e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Disa nga kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional i konsideron diskriminuese.

perti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurimi, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka vërejtur se AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE "LIMITPROJECT SH.P.K."

Në vendimin e AK-së, OE "LIMITPROJECT SH.P.K.", po ashtu është informuar se AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi Formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara, përmes të cilit ka bërë korrigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, për të cilat OE ankues kishte prezantuar pretendimet e tij ankimore përmes kërkesës për rishqyrtim.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, nuk ka bërë pretendime të reja në ankesën e dorëzuar pranë OSHP, karshi korrigjimit që ka bërë AK-ja. Pretendimet ankimore të parashtruara në Ankesën drejtuar OSHP-së, janë pretendime të cilat janë trajtuar nga AK-ja dhe janë korrigjuar në Formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “LIMITPROJECT” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “LIMITPROJECT” SH.P.K. janë të pabazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas

administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues, Komuna Prishtines, të datës 19.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë” me nr. të prokurimit: 616-24-7202-5-1-1.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/0716 të datës 17/08/2024.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE “LIMITPROJECT” SH.P.K vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - LIMITPROJECT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: